



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 1112 Prot.

Tiranë, më 22.05.2020

VENDIM

Nr. 8, datë 22.05.2020

**MBI KALENDARIN PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR DHE
PROVIMEVE PËR STUDENTËT E VITEVE TË FUNDIT QË NDJEKIN
STUDIMET NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, NË UMT,
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Në kuadër të mbylljes së vitit akademik 2019-2020, Vendimit Qarkullues nr. 37, datë 28.04.2020 "Mbi zhvillimin e proceseve akademike në situatën e krijuar nga infeksioni Covid-19, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë" të Senatit Akademik të UMT-së, Urdhrit nr. 104, datë 30.04.2020 "Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020..." të MASR, Urdhrit nr. 289, datë 04.05.2020 "Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmerren institucionet arsimore" të MSHMS, si dhe propozimeve të ardhura nga njësite kryesore, përkatësisht, shkresa nr. 176/6 prot., datë 19.05.2020 e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, shkresa nr. 964/3 prot., datë 20.05.2020 e Fakultetit të Mjekësisë dhe shkresa nr. 502/1 Prot., datë 20.05.2020 e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, pas diskutimit përkatës në mbledhjen e datës 22.05.2020, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Kalendarin për organizimin e procesit mësimor dhe provimeve për studentët e viteve të fundit që ndjekin studimet në programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë, bazuar në propozimet e fakulteteve të UMT-së, si më poshtë vijon:

I. Fakulteti i Mjekësisë:

Për studentët e vitit të fundit për të gjitha ciklet e studimit (Mjekësi e Përgjithshme, Farmaci dhe Shëndet Publik), për vitin 2019-2020:

- 24-30 Qershor Sezoni për provimet e pazhvilluar të semestrit të parë
- 1-7 Korrik Sezoni për provimet e mbartura (4 provime)
- 8-21 Korrik Sezoni për provimet e semestrit të dytë

- 22-30 Korrik Diploma

II. Fakulteti i Mjekësisë Dentare:

a) Kalendarit për organizimin e procesit mësimor dhe provimeve për studentët e vitit të fundit në programin Msc. në “Stomatologji”:

- 8-22 Qershor: studentët e vitit të fundit të programi të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” të rikthehet në auditor. Ndarja e studentëve të bëhet në nëngrupe dhe mësimi të organizohet në ambientet e katit të katërt dhe të pestë të FMD-së, duke respektuar distancimin fizik.
- 23 Qershor -17 Korrik: do të zhvillohen provimet e sezonit të verës për vitin e fundit të programit Msc në Stomatologji.
- 20 - 31 Korrik: do të jetë periudhë e zhvillimit të provimeve të sezonit që paraprin sezonin e diplomimit sipas rregullores së UMT-së për programin Msc në Stomatologji në datat.
- 24 Gusht- 14 Shtator: periudha e zhvillimit të Sezonit të Diplomimit

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

a) Për studentët e viteve të fundit dhe ata përsëritës të vitit të fundit që ndjekin studimet e tyre në programet e ciklit të parë Bachelor, procesi mësimor do të zhvillohet sipas kalendarit në vijim:

- 8-15 Qershor Zhvillim i praktikave lëndore.
- 15 Qershor – 6 Korrik Sezoni i provimeve të verës.
- 13-17 Korrik Sezoni për provimet e mbartura.
- 31 Korrik: Diplomimi.

b) Për studentët e ciklit të dytë Master Profesional, procesi mësimor do të zhvillohet sipas kalendarit në vijim:

- 8 – 26 Qershor Do të zhvillohet praktika lëndore
- 29 Qershor – 10 Korrik Do të zhvillohet praktika profesionale
- 22 Qershor-15 Korrik: Sezoni i provimeve ku do të përfshihen edhe provimet e pashlyera në semestrin e parë
- 22-27 Korrik: Sezoni i minivjeshtës që paraprin sezonin e diplomës (sipas rregullores së UMT-së).
- 29-30 Korrik Diplomimi

c) Për studentët e viteve të fundit dhe ata përsëritës të vitit të fundit që ndjekin studimet e tyre në programet e ciklit të dytë Master i Shkencave, procesi mësimor do të zhvillohet sipas kalendarit në vijim:

- Deri më datë 26 Qershor do të kryhet praktika profesionale
- 15-26 Qershor Sezon i semestrit të dytë dhe provimeve të pashlyera të semestrit të dytë

- 6-10 Korrik Minivjeshtës si dhe ai i praktikës profesionale
- 20-21 Korrik Diplomimi.

2. Për studentët e viteve të ndërmjetme, procesi i provimeve të menaxhohet nga Fakultetet përkatëse. si më poshtë:
 - a. Për lëndët që ka përfunduar programi përkatës, titullari i lëndës në dakordësi me studentët (bazuar në evidencën përkatëse për marrjen e mendimit të tyre) të vendose për kohën dhe formën (auditor ose online) e zhvillimit të provimit.
 - b. Për lëndët që programi nuk ka përfunduar ende, periudha e rikthimit në auditor të jetë pas datës 25 gusht 2020.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe i dërgohet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

REKTOR
Arben GJATI

